



Në bazë të nenit 2, paragrafi 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës , nenit 10 paragrafi A , pika 18 dhe nenit 134 të Statutit të Komunës së Drenasit , të dispozitave të Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale 01 nr. 031-520 të datës 04.09.2007, të nenit 40 dhe 41 paragrafi 1 , 2 të Ligjit mbi tregtinë e brendshme nr. 2004/18 si dhe në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 2007/03 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë , Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2008 , miratoi :

RREGULLOREN PËR

FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMIN E TREGTISË, HOTELERISË, ZEJTARISË DHE SHËRBIMEVE TË TJERA NË TERRITORINË E KOMUNËS SË DRENASIT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë, dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Drenasit, në bazë të nevojave dhe kërkesave të punonjësve dhe të qytetarëve .

Neni 2

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat e rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare : shoqëritë aksionare , shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar , bizneset individuale, ortakëritë etj , janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës , të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

Orari i fillimit dhe mbarimit të punës , i përcaktuar me këtë Rregullore , duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria ..
Duhet saktësuar orarin e punës para dite dhe pas dite , si dhe ditët që nuk punohet.

II. Koha e punës

Neni 4

Përcaktohet orari i punës në interval kohor :

Periodha verore fillon më 01.04.dhe zgjatë deri më 30.09 të vitit ,
Periodha dimërore fillon më01.10..dhe zgjatë deri me 31.03. të vitit.

4.1 Orari i punës i dyqaneve zejtare fillon prej orës 08.00.deris 20.00

4.2 Furrat e bukës do të punojnë çdo ditë prej orës 04.00.deris 22.00

Të dielave dyqanet zejtare nuk punojnë, përveç salloneve të ondulimit dhe kozmetikës .

4.3 Orari i punës i vetëshërbimeve , supermarketeve , dyqaneve tregtare :

- në periudhën verore prej orës07.00. deris 22.00.
- në periudhën dimërore prej orës08.00.deris 21.00.

Të dielave deris në ora 11.00

4.4 Orari i punës i depove të artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë :

- në periudhën verore prej orës08.00 deris 17.00
- në periudhën dimërore prej orës 08.00 deris 16.00

Të dielave nuk punohet

Neni 5

Hotelet , motelet do të punojnë :

- në periudhën verore prej orës00.deris 24.00 .
- në periudhën dimërore 00. deris 24.00.

VËREJTJE : Pas orës 24.00 nuk lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit të hotelit , motelit .



Në bazë të nenit 2, paragrafi 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës , nenit 10 paragrafi A , pika 18 dhe nenit 134 të Statutit të Komunës së Drenasit , të dispozitave të Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale 01 nr. 031-520 të datës 04.09.2007, të nenit 40 dhe 41 paragrafi 1 , 2 të Ligjit mbi tregtinë e brendshme nr. 2004/18 si dhe në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 2007/03 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë , Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2008 , miratoi :

RREGULLOREN PËR

FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMIN E TREGTISË, HOTELERISË, ZEJTARISË DHE SHËRBIMEVE TË TJERA NË TERRITORINË E KOMUNËS SË DRENASIT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë, dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Drenasit, në bazë të nevojave dhe kërkesave të punonjësve dhe të qytetarëve .

Neni 2

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat e rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare : shoqëritë aksionare , shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar , bizneset individuale, ortakëritë etj , janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës , të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

Orari i fillimit dhe mbarimit të punës , i përcaktuar me këtë Rregullore , duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria ,. Duhet saktësuar orarin e punës para dite dhe pas dite , si dhe ditët që nuk punohet.

II. Koha e punës

Neni 4

Përcaktohet orari i punës në interval kohor :

Periudha verore fillon më 01.04.dhe zgjatë deri më 30.09 të vitit ,
Periudha dimërore fillon më01.10..dhe zgjatë deri me 31.03. të vitit.

4.1 Orari i punës i dyqaneve zejtare fillon prej orës 08.00.der 20.00

4.2 Furrat e bukës do të punojnë çdo ditë prej orës 04.00.der 22.00

Të dielave dyqanet zejtare nuk punojnë, përveç salloneve të ondulimit dhe kozmetikës .

4.3 Orari i punës i vetëshërbimeve , supermarketeve , dyqaneve tregtare :

- në periudhën verore prej orës07.00. der 22.00.
- në periudhën dimërore prej orës08.00.der 21.00.

Të dielave deri në ora 11.00

4.4 Orari i punës i depove të artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë :

- në periudhën verore prej orës08.00 der 17.00
- në periudhën dimërore prej orës 08.00 der 16.00

Të dielave nuk punohet

Neni 5

Hotelet , motelet do të punojnë :

- në periudhën verore prej orës00.der 24.00 .
- në periudhën dimërore 00. der 24.00.

VËREJTJE : Pas orës 24.00 nuk lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit të hotelit , motelit .

Neni 6

6.1 Kafe – baret , internet- kafet , disko-klubet do të punojnë :

- në periudhën verore prej orës07.00 deri 23.00.
- në periudhën dimërore prej orës08.00 deri 22.00.

6.2 Restorantet, ëmbëltoreset e të ngjashmet do të punojnë në këtë “

- në periudhën verore prej orës 07.00 deri 24.00
- në periudhën dimërore prej orës 08.00 deri 23.00

Klubet e natës do të punojnë me këtë orar : gjatë periudhës verore dhe dimërore prej orës 23.00 deri 05.00.

Veprimtaritë e lartpërmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni , gjatë orarit të punës nuk mund tu prishin qetësin qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre, qoftë me muzikë apo me forma të tjera .

Neni 7

Tregjet e gjelbra : Tregu në Drenas (çdo të enjte) dhe në Bushat (çdo të shtunë) do të punojnë më këtë orar :

- në periudhën verore prej orës07.00 deri 18.00
- në periudhën dimërore prej orës08.00 deri 17.00

Tregu i kafshëve : në Drenasin III (çdo të Enjte) dhe në Bushat (çdo të shtunë) do të punojnë prej orës 07.00 deri 15.00

Neni 8

Përfshirje nga dispozitat e nenit 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje bëjnë objektet që gjenden jashtë vendbanimeve dhe mund të punojnë më shumë se orari i punës , i përcaktuar me pëlqimin e Drejtorisë për financa ,ekonomi dhe zhvillim .

Neni 9

Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi të objekteve të banimit e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio mjete për riprodhimin e programit, programi nuk mund të mbahet pas orës 23.00.
Me “ afërsi të drejtpërdrejtë “ kuptohet largësia 100 m nga objekti i banimit.

Neni 10

Objektet për shitjen e karburanteve do të punojnë në këtë orar :

- në periudhën verore dhe dimërore prej orës06.00 deri 24.00

Së paku dy pika shitjeje do të kujdestarojnë nën-stop 24 orë, orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë subjektet afariste të cilat merren me shitjen e karburanteve . Orari do të hartohet për 1 muaj dhe do t'i dorëzohet inspektionit të tregut në fund të muajt për muajin vijues .

Neni 11

Barnatoret do të punojnë me këtë orar :

- për periudhën verore prej orës08.00 deri 20.00
- për periudhën dimërore prej orës 08.00 deri 19.00

Së paku dy barnatore do të punojnë nën – stop 24 orë . Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojë vet barnatoret . Orari do të hartohet për 1 muaj dhe do t'i dorëzohet inspektionit të tregut për muajin vijues .
Orari i kujdestarisë do të caktohet sipas alfabetit të mbishkrimeve të subjekteve afariste dhe të gjitha subjektet afariste kanë obligim që të vendosin orarin e kujdestarisë.

III. Zgjatja e orarit të punës

Neni 12

Restorantet, kafe-baret, dyqanet hoteliere , vetëshërbimet , supermarketet, dyqanet tregtare, mund të punojnë më gjatë se orari i punës i përcaktuar me këtë rregullore. Për punën më të gjatë se orari i parapar , duhet marrë me pëlqimin e Drejtorisë për financa , ekonomi dhe zhvillim.

Për çdo orë pune më gjatë se orari i punës duhet paguar :

- objektet hoteliere (restorantet, kafe-baret, dyqanet hoteliere)10.00 Euro.
- Supermarketet , vetëshërbimet , dyqanet tregtare) 5.00Euro.

Neni 13

Subjektet afariste, mund të zgjasin orarin e punës si në rastet :

- për festat kombëtare01.00
- për festat fetare01.00,

- për festën e gruas 8 Marsi , orari zgjatë deri në orën 01.00,
- për festën “ Shën Valentini” , orari zgjatë deri në orën 01.00
- për festën e vitit të Ri , orari zgjatë deri në orën04.00,
- për ditën e çlirimit të Drenasit , orari zgjatë deri në orën 01.00 .

Për rastet e cekura më lartë nuk duhet të paguhet taksa dhe tarifa komunale.

IV. Dispozitat ndëshkuese

Neni 14.

Të gjitha subjektet afariste të cilat nuk do ta respektojnë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës , të paraqitur në nenet 4 , 5 , 6 , 7 e i cili do të konstatohet nga inspeksioni apo policia , do të dënohen për kundërvajtje :

- personat juridikë..... 300 deri 400 Euro ,
- personat fizikë 150 deri 250 Euro .

Neni 15.

Të gjitha subjektet afariste të cilat do të konstatohet se kanë zgjatur orarin pa pëlqimin dhe Vendimin e Drejtorisë për financa , ekonomi dhe zhvillim, do të gjobiten për kundërvajtje :

- personat juridikë 250 deri 350 Euro,
- personat fizikë 150 deri 250 Euro.

V. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 16.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset : Drejtoria e financave , ekonomisë dhe zhvillimit , ndërsa mbikëqyrjes do të bëjë Drejtoria e Inspektionit – dhe policia .

Neni 17.

Personat juridikë , gjegjësisht themeluesit e dyqaneve janë të obliguar që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e këtij vendimi, ditën e nesërme nga dita e hyrjes në fuqi të tekstit të spastruar të kësaj Rregulloreje .

Neni 18.

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet çdo vendim i mëparshëm komunal që ka rregulluar fillimin dhe mbarimin e orarit të punë për subjektet afariste.

Neni 19.

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës .

KUVENDI I KOMUNËS SË DRENASIT

01 NR. 330-5638 DATË 31.07.2008



KRYETARI I KUVENDIT

Nexhat Demaku
z. Nexhat Demaku